



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. _____ prot.

Tiranë, datë ____/____/2019.

RAPORT

**MBI HARTIMIN E PROGRAMIT EKONOMIK DHE FINANCIAR TË VEPRIMTARISË
SË ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE PËR VITIN 2020.**

Me qëllim hartimin e programit ekonomik dhe financiar të veprimtarisë së Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2020, me shkresën Nr.2424 datë 11.11.2019 “Mbi hartimin e programit ekonomik dhe financiar të vitit 2020”, Drejtori i Përgjithshëm ka dhënë udhëzime për Degët Rajonale dhe Drejtoritë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të EKB-së për përgatitjen e programit ekonomik dhe financiar, lidhur me programimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, investimeve ndërtimore dhe jo ndërtimore të veprimtarisë për vitin 2020.

Në mbështetje të Ligjit Nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar, VKM Nr. 198, datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave“, i ndryshuar, si dhe në Statutin e EKB-së nr. 325/2 prot., datë 25.02.2019, gjatë muajit nëntor 2019, Degët Rajonale të EKB-së dhe Drejtoritë pranë Drejtorisë së Përgjithshme kanë përgatitur projekt-programin ekonomik dhe financiar për vitin 2020.

Për këtë, programi ekonomik i vitit 2020 është hartuar në bazë të trendit të viteve të mëparshme, të plotësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, përdorimin me efektivitet të burimeve ekzistuese lidhur me të ardhurat e Entit, dhe konkretisht të ardhurat e vitit 2020 përfshijnë:

- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara ndër vite nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorëve të ndryshëm.
- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara nga EKB me fondet e veta,
- Të ardhurat nga interesat për kontratat e lidhura ndër vite nga Degët Rajonale të EKB-së,
- Të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit dhe garazheve, të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së.
- Të ardhurat nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM,

- Të ardhurat nga 4% (pagesa e shpenzimeve operationale për EKB-në), ku përfshihen vlera e kontratave të reja të apartamenteve e njësisve të banimit të objekteve me VKM.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare, për fondet e lira gjendje në bankat e nivelit të dytë.
- Të ardhurat të tjera, ku përfshihen të ardhurat nga biletat e parkut të automjeteve, nga gjobat dhe penalitetet, etj.

Në përfundim të punës së kryer nga Degët Rajonale të EKB-së për hartimin e këtij projekt-programi, janë përgatitur dhe pasqyruar treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të cilët janë rishikuar nga Drejtoria e Përgjithshme, për të bërë të mundur maksimalizimin e të ardhurave dhe përdorimin me efecencë të shpenzimeve për vitin 2020.

Projekt-programi ekonomik dhe financiar i EKB-së që paraqesim Këshillit Drejtues trajton çështjet kryesore si vijon:

- I. Objektivat e programit ekonomik dhe financiar.
- II. Planifikimi i treguesve ekonomik dhe financiar të veprimtarisë
- III. Parashikimi dhe detajimi i planit të investimeve ndërtimore
- IV. Plani i aktiviteteve mbështetëse.
- V. Planifikimi i veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm

I. Objektivat e Programit Ekonomik dhe Financiar.

Enti Kombëtar i Banesave në këtë projekt-program ka parashikuar burimet për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimimin e veprimtarisë së tij, në planifikimin e investimeve të reja, si dhe vazhdimin e ndërtimit të nisur gjatë vitit 2019.

Për vitin 2020, programimi i investimeve është hartuar vetëm me ato Bashki që kanë ofruar sheshe ndërtimi, dhe aktualisht janë siguruar sheshe ndërtimi në Vlorë për 2 banesa, 1 në Maliq, 1 në Has dhe 2 në Kukës, si dhe përfundimin e punimeve të banesës në qytetin e Gramshit.

Nisur nga sa më sipër, janë përcaktuar objektivat e Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2020, të cilat i paraqiten Këshillit Drejtues për miratim, së bashku me programin ekonomiko-financiar, si më poshtë:

- 1- Të realizojë të ardhurat në shumën **154,900,000 lekë** gjatë aktivitetit ekonomik dhe financiar, dhe të mbajë nën kontroll shpenzimet e veprimtarisë të programuara në shumën **97,900,000 lekë**.
- 2- Të realizojë një fitim bruto prej **57,000,000 lekë**.
- 3- Të realizojë gjatë vitit një nivel investimi prej rreth **331,725,100 lekë** për fillimin e ndërtimit të **247** apartamenteve të banesave të reja në qytetet Vlorë 2, Maliq 1, Has 1, Kukës 2, si dhe përfundimi i objektit në qytetin e Gramshit i trashëguar nga viti 2019.
- 4- Në fushën e investimeve, objektivi i vitit 2020 do të jetë: Përfundimi i banesës të nisur në vitin 2019, pra të banesës në Gramsh, fillimi i ndërtimit të banesave për të pastrehët në qytetet: Vlorë, Maliq, Kukës dhe Has, zgjerimin e bashkëpunimit të EKB-së me organet e

vetëqeverisjes vendore, për sigurimin e shesheve të ndërtimit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët për strehimin e familjeve të pastreha.

- 5- Të realizohet gjatë vitit, strehimi i 71 familjeve, nëpërmjet shitjes së banesave të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit dhe me fondet e veta të EKB-së.
- 6- Të bëhet e mundur shitja, e 34 njësive të shërbimit dhe 18 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve, nga të cilat njësitë e shërbimit, 3 në Durrës, 3 në Kavajë, 3 në Sarandë, 6 në Fier, 5 në Berat, 5 në Librazhd, 9 në Korçë, si dhe të 18 garazheve në Korçë.
- 7- Të ulet numri i klientëve debitorë në nivelin 30 % ose 260 debitorë të trashëguar nga gjëndja vitit 2019.
- 8- Të sigurohen titujt e pronësisë të njësive të banimit për objektet me VKM që janë dhënë në administrim për privatizim EKB-së, ku programohen të lidhen 121 kontrata të reja, nga të cilat 85 në Tiranë, 30 në Durrës, 4 në Korçë dhe 2 në Vlorë.
- 9- Të merren masa për të siguruar përdorimin e fondeve të lira (në depozita bankare) për mbështetjen e politikave sociale të strehimit të të pastrehëve.
- 10- Ndjekja me përparësi të detyrave që rezultojnë nga zbatimi i ligjit të strehimit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

II. Programimi i Treguesve Ekonomik dhe Financiar të Veprimtarisë

A. Planifikimi i të Ardhurave

Burimet kryesore të të ardhurave financiare për vitin 2020 për Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të EKB-së do të jenë si më poshtë:

- a) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara ndër vite nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorëve të ndryshëm
- b) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së.
- c) Të ardhurat nga 4% (pagesa e shpenzimeve operationale për EKB-në), ku përfshihen vlera e kontratave të reja të apartamenteve e njësive të banimit të objekteve me VKM.
- d) Të ardhurat nga shitja e njësive të banimit të objekteve të privatizuara me VKM dhe nga lidhja e kontratave të reja gjatë vitit, si në Tiranë, Durrës, Korçë dhe Vlorë.
- e) Të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit në: Fier, Durrës, Kavajë, Gjirokastër, Berat, Librazhdë, Korçë, si dhe të garazheve në Korçë.
- f) Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura ndër vite dhe nga ato që do të lidhen gjatë vitit 2020.
- g) Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare për fondet e lira të EKB-së.

- h) Të ardhura të tjera, ku përfshihen të ardhurat nga parkimi i mjeteve të të tretëve, të ardhurat nga qiratë, gjobat e penalitetet, etj.

Programi i të ardhurave sipas zërave kryesor, për Degët Rajonale dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqitet si më poshtë:

Në Lekë

N R	Emërtimi	Nga shitja- Apartamente dhe njësitë e shërbimit	Të ardhura nga 4%	Të ardhura nga privatizime me VKM	Të ardhura nga interesat e kontratave	Të ardhura të tjera	TOTALI
1.	Tiranë		960 000	36 625 000	6 270 000	360 000	44 215 000
2.	Fier	4 435 600			6 334 000	200 400	10 970 000
3.	Durrës	9 781 400	1 901 600		5 000 000	200 000	16 883 000
4.	Berat	4 648 400			2 022 000	71 600	6 742 000
5.	Korçë	3 632 300	30 700		5 400 000	162 000	9 225 000
6.	Gjirokastrë	16 562 000	393 000		1 138 000	184 000	18 277 000
7.	Shkodër	3 927 300			2 041 500	250 200	6 219 000
8.	Elbasan	4 097 500	60 000		3 300 000	200 500	7 658 000
9.	Vlorë		100 000	1 600 000	1 540 000	280 000	3 520 000
10.	Kukës	615 300	183 000		1 478 000	404 700	2 681 000
11.	Dibër	855 400	137 100		914 200	678 300	2 585 000
12.	Lezhë	675 000	150 000		2 600 000	700 000	4 125 000
13.	Dr.Përgjith.				1 200 000	20 600 000	21 800 000
	TOTALI	49 230 200	3 915 400	38 225 000	39 237 700	24 291 700	154 900 000

Siç del nga pasqyra e mësipërme, në planin e të ardhurave për vitin 2020, të ardhurat nga shitja zenë 31,8%, të ardhurat nga interesat e kontratave 25,3%, të ardhurat nga privatizimet me VKM 24,7%, të ardhurat nga 4% zenë 2,5% dhe të ardhurat e tjera 15,7%.

Më hollësisht programi i treguesve kryesor të të ardhurave nga shitja paraqiten si më poshtë:

Planifikimi i të Ardhurave nga Kthimi i Kësteve të Kredive.

Këtu përfshihen të ardhurat nga kthimi i kredisë, së klientëve që kanë përfituar apartamente të ndërtuara nga EKB-ja ndër vite. Për vitin 2020 janë planifikuar të ardhura, nga vjelja e kësteve të 2,365 klientëve, ku parashikohen të arkëtohen, të ardhura bruto nga shitja në vlerën **113,955,300** lekë.

Për vitin 2020 janë programuar të lidhen 71 kontrata të reja, për apartamentet e ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit dhe të EKB-së, nga të cilat, në Durrës 3, Gjirokastrë 2, Shkodër 20, Elbasan 1, Kukës 7, Dibër 6, Lezhë 5, Kavajë 3, Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme 24 (nga objektet në qytetin e Pukës) në vlerën **139,397,000** lekë.

Planifikimi i të Ardhurave nga Privatizimet me VKM

Këtu përfshihen të ardhurat nga kthimi i kredisë, së klientëve që kanë përfituar njësi banimi me VKM ndër vite. Për vitin 2020 janë planifikuar të ardhura, nga vjelja e kësteve të 684 klientëve, ku parashikohen të arkëtohen, të ardhura bruto nga shitja në vlerën **19,905,000** lekë.

Njëkohësisht në këtë zë përfshihen edhe të ardhurat nga privatizimet 117 njësi të reja të banimit të objekteve me VKM, nga të cilat: 85 Tiranë, 30 në Durrës dhe 2 në Vlorë. Të ardhurat bruto nga shitjet për këto njësi banimi llogariten, janë planifikuar në shumën prej **73,410,000** lekë.

Planifikimi i të Ardhurave nga Shitja e Njësive të Shërbimit

Gjatë vitit 2020 janë planifikuar të shiten njësitë e shërbimit dhe programohen 34 kontrata, nga të cilat: 6 në Fier, 3 në Durrës, 3 në Kavajë, 5 në Berat, 3 në Gjirokastrë (Sarandë), 5 në Elbasan (Librazhdë), 9 në Korçë, si dhe 18 garazhe në Korçë të cilat programohen në shumën prej **117,331,400** lekë.

Të Ardhura nga Interesat e Kontratave të Lidhura

Gjatë vitit 2020, janë planifikuar të realizohen të ardhura nga interesat e kontratave të lidhura, të klientëve që kanë përfituar apartamente, të ndërtuara nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit, Bankës Botërore dhe donatorë të tjerë. Në këtë tregues përfshihen edhe të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura për banesat e ndërtuara me fondet e veta të Entit Kombëtar të Banesave.

Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura për këto apartamente, llogariten në shumën prej **39,237,700** lekë.

Të Ardhurat nga 4% e Lidhjes së Kontratave të Reja

Përgjatë vitit 2020 janë planifikuar të realizohen të ardhura nga 4% (shpenzime operacionale të EKB-së) që llogariten nga shitja e apartamenteve të ndërtuara ndër vite me fondet e Buxhetit të Shtetit, donatorë të tjerë, dhe nga banesat e ndërtuara nga EKB me fondet e veta. Për këtë vit janë programuar gjithësejt shuma prej **3,915,700** lekë, nga e cila për apartamentet e përfunduara në shumën 1,397,700 lekë, dhe nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM në shumën 2,518,000 lekë.

Të Ardhurat nga Interesat e Depozitave Bankare

Mbështetur në gjendjen e depozitave dhe mirëmenaxhimin e fondeve të lira monetare, për vitin 2020 janë planifikuar interesat nga depozitat bankare me afat maturimi një vjeçar në shumën prej **17,030,000** lekë.

Të Ardhura të Tjera.

Këtu përfshihen të ardhurat e programuara nga shitja e biletave për parkimet e mjeteve ndaj të tretëve në shumën **3,570,000** lekë, nga kamatë-vonesat dhe penaltitetet dhe të tjera në shumën **3,691,700** lekë.

Më poshtë paraqitet një tabelë krahasuese i të ardhurve sipas zërave kryesor të të ardhurave:

NR	EMËRTIMI	PLANI 2017	PLANI 2018	PLANI 2019	PLANI 2020
1	Të ardhurat nga shitja	48 836 800	37 785 900	46 886 100	49 230 200
2	Të ardhura nga 4%	17 358 600	5 291 700	12 172 300	3 915 400
3	Privatizimet me VKM	25 845 600	35 698 000	33 023 200	38 225 000
4	Nga interesat e kontratave të lidhura	21 613 400	33 581 800	37 370 900	39 237 700
5	Interesat e depozitave	27 009 000	26 000 000	17 000 000	17,030,000
6	Të ardhura të tjera	4 849 400	5 202 400	4 723 400	7,261,700
7	TOTALI	145 512 800	143 559 800	151 176 000	154 900 000

Siç del edhe nga të dhënat e tabelës si më sipër, rezulton se programi i të ardhurave për vitin 2020 parashikohet me 10,2% më tepër nga plani 2019, ose me shumë 3,724 000lekë, dhe sipas zërave kryesor janë programuar si vijon:

- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve dhe njësive të shërbimit janë planifikuar 5% më tepër nga plani 2019 ose më tepër 2,344,100 lekë.
- Të ardhurat nga 4% janë pakësuar me 77,8 %, ose më pak 8,256,900 lekë, mbasi në këtë vit programohen të lidhen më pak kontrata se viti i kaluar.
- Të ardhurat nga privatizimet enjësive të banimit të objekteve me VKM janë planifikuar më tepër 15,7% ose 5,201,800 lekë.
- Të ardhurat nga interesat e kontratave janë në rritje me 5% ose më tepër 1,867,700 lekë, mbasi në vitin 2020 janë në arkëtim mbi 120 kontrata të reja të lidhura në vitin 2019.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave janë rritur me 1,7%, ose më tepër për 30,000 lekë se planifikimi i vitit 2019, pasi normat e interesit janë ulur ndjeshëm nga Banka e Shqipërisë dhe se nga gjendja e depozitave parashikohen të përdoren për investime në ndërtimin e banesave për të pastrehët, në Bashkitë Vlorë, Maliq, Has dhe Kukës.
- Të ardhurat e tjera janë rritur me 53,7%, ose më tepër për 2,538,300 lekë, ku përfshihen të ardhurat nga shitja e biletave të mjeteve të të tretëve, të ardhurat nga qiratë, gjobat e penaltitetet, etj.

B. Planifikimi i Shpenzimeve të Veprimtarisë së EKB-së.

Në planifikimin e zerave kryesor të shpenzimeve është mbajtur parasysh që të përballohen nevojat e domosdoshme për funksionimin normal të veprimtarisë gjatë vitit 2020.

Konkretisht programi i shpenzimeve në Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme për vitin 2020, pasqyrohet si më poshtë:

Në Lekë

NR.	Emërtimi	PLANI 2017	PLANI 2018	PLANI 2019	PLANI 2020
1.	Tiranë	5,969,800	6,213,200	5 063 000	5 029 000
2.	Fier	3,465,100	3,515,200	3 465 100	3 353 000
3.	Durrës	4,850,200	4,198,600	4 232 000	4 948 000
4.	Berat	4,601,500	2,519,500	2 459 600	2 371 000
5.	Korçë	3,264,700	3,236,100	3 445 500	3 353 000
6.	Gjirokastrë	3,030,300	3,082,000	3 093 300	2 596 000
7.	Shkodër	3,237,800	2,914,800	3 274 400	3 214 000
8.	Elbasan	3,636,400	3,461,500	3 443 400	3 442 000
9.	Vlorë	2,941,000	3,238,800	3 491 100	3 403 000
10.	Kukës	2,151,500	2,131,300	2 139 400	2 130 000
11.	Dibër	2,405,700	2,452,700	2 347 700	2 355 000
12.	Lezhë	2,995,900	3,284,800	3 321 500	3 543 000
13.	Dr.Përgjith	59,624,802	58,400,000	58 400 000	58 163 000
	TOTALI	102,174,702	98,818,800	98 176 000	97 900 000

Siç del nga tabela më sipër, shpenzimet e veprimtarisë për vitin 2020 janë programuar më pak 276,000 lekë krahasuar me vitin 2019.

Më hollësisht programimi i shpenzimeve sipas nënzërave kryesor të tyre për vitin 2020, krahasuar me planet e tre vitet më parë, paraqitet si më poshtë:

N R.	SHPENZIMET	PLANI 2017	PLANI 2018	PLANI 2019	PLANI 2020
1.	Shpenzime administrative	2 297 000	2 276 000	2 335 000	2 174 000
2.	Shpenzime Energji-Ujë	1 625 200	1 572 500	1 583 000	1 459 300
3.	Shpenzime Udhëtime-Dieta	2 366 600	2 353 000	2 092 000	2 070 000
4.	Shpenz Postare-Telefonike	1 244 000	1 288 000	1 150 000	1 132 000
5.	Komisione Bankare	142 800	141 300	152 100	160 400
6.	Pagat e Punonjësve	64 205 579	64 810 400	63 730 6	63 445 200
7.	Kontributet Sig Shoqërore	10 724 223	10 823 400	10 684 100	10 597 600
8.	Shpenzime Tatim Taksa	1 000 000	321 300	397 300	359 500
9.	Shpenzime Pritjeje	40 000	40 000	50 000	50 000
10.	Interesi Bankës Botërore	3 000 000	1 200 000	-	-
11.	Shpenzime rojeve civile	2 100 000	2 160 000	2 200 000	2 100 000
12.	Shpenzi Ekspertit Kontabël	1 200 000	1 200 000	1 200 000	1 400 000
13.	Honorare Këshilli Drejtues	1 700 000	1 800 000	1 800 000	2 100 000
14.	Trajnime e Seminare	280 000	480 000	280 000	280 000
15.	Penalitete e Gjoha	1 000 000	1 500 000	1 750 000	2 100 000
16.	Shpenzime Riparime	200 000	240 000	850 000	1 000 000
17.	Mirëmbajtje e Alpha	450 000	900 000	450 000	240,000

18.	Shpenzime e Qera zyresh	360 000	396 000	707 000	707 000
19.	Shpenzime Amortizimi	4 158 600	3 815 900	3 816 250	3 991 600
20.	Shpenzime të tjera	1 440 000	501 000	761 500	859 000
21.	Shpenz 1% të përndjekurit			637 150	634 400
22	Reklamime TV - dyqanet			400 000	240 000
23	Shpenz antarësimi hoasing	400 000	400 000	400 000	400 000
24	Shpenzim hapje të gjyqeve	200 000	200 000	350 000	400 000
	SHUMA	102 174 702	98 818 800	98 176 000	97 900 000

Siç del edhe nga tabela, për vitin 2020 shpenzimet e veprimtarisë janë parashikuar me ulje 0,3% ose 276,000 lekë krahasuar me planin e vitit 2019. Bazuar në treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve, rezultati financiar i programuar për çdo Degë Rajonale dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqitet si vijon:

NR.	DEGA	PLANI I TË ARDHURAVE	PLANI I SHPENZIMEVE	REZULTATI FINANCIAR
1	Tiranë	44 215 000	5 029 000	39 186 000
2	Fier	10 970 000	3 353 000	7 617 000
3	Durrës	16 883 000	4 948 000	11 935 000
4	Berat	6 742 000	2 371 000	4 371 000
5	Korçë	9 225 000	3 353 000	5 872 000
6	Gjirokastër	18 277 000	2 596 000	15 681 000
7	Shkodër	6 219 000	3 214 000	3 005 000
8	Elbasan	7 658 000	3 442 000	4 216 000
9	Vlorë	3 520 000	3 403 000	117 000
10	Kukës	2 681 000	2 130 000	551 000
11	Dibër	2 585 000	2 355 000	230 000
12	Lezhë	4 125 000	3 543 000	582 000
13	Dr.Përgjith	21 800 000	58 163 000	-36 363 000
	TOTALI	154 900 000	97 900 000	57 000 000

Rezultati financiar për vitin 2020 është parashikuar me rritje 7,5 % më tepër se plani 2019, ose rreth 4,000,000 lekë. Siç del nga të dhënat e pasqyrës, për vitin 2020 nuk është planifikuar asnjë Degë Rajonale me humbje.

Rezervat dhe Rrisqet

Plani i të ardhurave nga shitja e njësive të shërbimit dhe garazheve mund të reduktohet për mungesë kërkesash nga subjektet e interesuara.

Adresimi i Rrisqeve

Ecuria e shitjeve me ankand të njësive të shërbimeve dhe garazheve të banesave të ndërtuara

me fondet e veta të EKB-së, në qytetet Fier, Sarandë, Kavajë, Berat, Librazhd, Durrës dhe Korçë.

III. Parashikimi dhe Detajimi i Planit të Investimeve Ndërtimore.

Për vitin 2020, parashikimi i investimeve është hartuar vetëm me ato Bashki që kanë ofruar sheshe ndërtimi dhe janë angazhuar të bashkëpunojnë. Aktualisht EKB ka siguruar sheshe ndërtimi në Bashkitë Kukës dhe Has. Në Vlorë dhe Maliq sheshi i ndërtimit është gati dhe së shpejti pritet të fillojë puna për ndërtimin e objekteve të reja, duke qënë se këto investime janë në fazë prokurimi. Pritet përfundimi i punimeve të rrjetit inxhinjerik të banesave në qytetin e Pukës.

Në fushën e investimeve, objektivi i vitit 2020 do të jetë:

- a. Përfundimi i banesës të nisur në vitin 2019, pra të banesës në Gramsh,
- b. Fillimi i ndërtimit të banesave për të pastrehët në qytetet: Vlorë, Maliq, Kukës, Has
- c. Zgjerimin e bashkëpunimit të EKB-së me organet e vetëqeverisjes vendore, për sigurimin e shesheve të ndërtimit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët për strehimin e familjeve të pastreha.

d. Parashikimi dhe Detajimi i Planit të Investimeve Ndërtimore.

Lekë

NR	Emërtimi	Vlera e projektit	Vlera e Kontratës	PLANI 2019	FAKTI 2019	PLANI 2020
A	Investime të programuara për vitin 2020	248 488 000				80 500 000
1	Ndërtim Objekti Kukës	246,613,000				80,000,000
2	Mbikqyrje Punimesh. Objektit Kukës	1,875.000				500,000
B	Investime të mbartura nga Viti 2019	708,343,117	362,552,053		58,983,024	251,225,100
1	Ndërtim. Objekti Gramsh	130,000,000	91,000,000	80,000,000	21,357,009	69,643,000
2	Mbikqyrje Objektit Gramsh	1,120,000	682,100	682,100		682,100
4	Ndërt. Objektit Vlorë	260 000 000	206,000,000	40 000 000	188 000	120,000,000
5	Mbikqyrje Punimesh. Vlorë	1,577,604	-faze prokurimi	200 000		300,000
6	Ndërtim Objekti Maliq	95,740,302	-faze prokurimi		168 000	40,000,000

7	Ndërtim Objekti Has	125,200,000			48,000	20,000,000
8	Mbikqyrje Punimesh.Objektit Maliq	957,211				400,000
9	Mbikqyrje Punimesh.Objekti Has	1,500,000				200,000
10	Ndërtim.Objekti Korçë			7,655,071	1,616,979	Përfunduar
11	Ndërtim.Objekti Durrës			18 000 000	17 929 236	Përfunduar
12	Studim projektim rrjeti inxh Durrës	60,000	60,000	60,000	60,000	Përfunduar
13	Ndërtim.rrjeti inxh Durrës		85,200		85,200	Përfunduar
14	Ndërtim.rrjeti inxhenj Korçë	2,700,000	2,150,000	2 150 000	2,150,000	Përfunduar
15	Ndërtim.rrjet inxhenj Durrës	3,500,000	2,270,425	2,270,425	2,229,214	Përfunduar
16	Ndërtim.Objekti Pukë	73,000,000	53,190,979	18,600,000	17,970,934	Përfunduar
17	Ndërtim.rrjet inxhenj Pukë	12,000,000	6,618,169	6,618,169	6,618,114	Përfunduar
18	Mbikqyrje Punimesh. Pukë	880,000	387,180	387,180	387,180	Përfunduar
19	Mbikqyerje.rrjet inxhenj Pukë	108,000	108,000	108,000	108,000	Përfunduar
	TOTALI (A+B)	956,831,117	362,552,053	176,730,945	58,983,024	331,725,100

Për vitin 2020 janë planifikuar **331,725,100** lekë, nga të cilat **80 500 000** lekë investime të reja dhe **251,225,100** lekë për financimin e investimeve të mbartura nga viti 2019.

Më poshtë jepen disa sqarime për investimet e planifikuara:

1. Në objektin në Gramsh me vlerë 88 870 387 lekë dhe afat kohor 400 ditë kalendarike, punimet filluan me vonesë pasi zgjati shuma procedura e prokurimit. Aktualisht puna po vazhdon me ritme sipas grafikut të miratuar të punimeve. Për vitin 2020 pritet që ky investim të përfundojë.
2. Objekti në Vlorë me vlerë 199,368,608 dhe afat kohor 365 ditë kalendarike, ndodhet në procedurë prokurimi (faza e shpalljes së fituesit). Gjithashtu për këtë objekt është shpallur procedura për mbikqyrjen e punimeve për këtë objekt.

3. Për investimet që do të kryhen në Bashkitë Kukës dhe Has janë kryer procedura paraprake për kalimin e pronësisë në emër të Entit si dhe kërkesa për sizmicitetin e këtyre dy trojeve, për ti paraprirë praktikave shkresore që nevojiten për aplikim për leje zhvillimi dhe ndërtimi duke qënë se në të dy këto objekte do të zbatohet objekti tip që EKB-ja disponon.
4. Për investimin që do të kryhet në Bashkinë Maliq janë kryer procedura paraprake për kalimin e pronësisë në emër të entit si dhe kërkesa për sizmicitetin. Është realizuar studimi gjeologjik dhe VNM, ka dale leja e zhvillimit dhe po bëhet gati dosja për Leje ndërtimi. Është në proces procedura e prokurimit për ndërtimin e këtij objekti.

IV. Plani i Aktiviteteve Mbështetëse.

1. Planifikimi i procedurave të prokurimeve të parashikuara për vitin 2020.

Gjatë vitit 2020, nga EKB-ja në varësi të investimeve ndërtimore, janë parashikuar të realizohen prokurimet sipas pasqyrës si më poshtë:

NR.	Emërtimi i zerave kryesor të investimeve	Vlera me TVSH
1	Ndërtim të dy objekteve në Kukës	246,613,000
2	Mbikqyrje punimesh të dy objekteve në Kukës	1,875.000
3	Ndërtim Objekti Has	125,200,000
4	Mbikqyrje Punimesh objektit Has	1,500,000
	TOTALI	375,188,000

Ndërsa për investimet jo ndërtimore, për blerje mobileri-orendi zyrash dhe paisje elektronike, si dhe të shpenzimeve administrative të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së EKB-së, janë parashikuar të realizohen prokurimet sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr.	Zërat me artikuj	Fondi me TVSH
I	Investimet jo ndërtimore	
1	Blerje mobileri dhe orendi zyrash	480,000
2	Blerje paisje elektronike	960,000
	Shuma	1,440,000
II	Shpenzime administrative	
1	Blerje Karburant	1,200,000
2	Blerje Materiale Kancelarie	600,000
3	Blerje Tonera për Fotokopje dhe Printera	550,000
4	Blerje pjesë Elektrike	120,000
5	Blerje pjesë hidraulike	120,000
6	Blerje pjesë elektronike	120 000
7	Blerje materiale higjeno sanitare	240 000

8	Riparimi i automjeteve	580 000
9	Shërbim- larje e automjeteve	120,000
10	Siguracioni i automjeteve dhe taksa	150 000
11	Blerje mallra për pritje	50 000
12	Riparim fotokopje dhe printera	120,000
13	Blerje bileta për udhëtime jashtë vendit	480,000
14	Riparime kondicionerësh	120,000
15	Riparime hidraulike	50,000
16	Organizim seminare, trajnime, etj.	280 000
17	Shërbime për rinovim programi Alpha dhe trajnime të specialistëve të financës	240 000
18	Mirëmbajtja e faqes zyrtare të EKB-së	120 000
19	Reklamime në TV për shitjen e dyqaneve	240 000
20	Pagesë të kuatës Hausing Europë	400 000
	TOTALI	5,900,000

2. Subvencionimi i interesave të kredive me kushte lehtësuese dhe trajtimi me kredi i familjeve qiramarrëse në ish pronë private.

Në zbatim të politikave të strehimit të miratuara nga shteti dhe detyrave i janë ngarkuar me aktet ligjore e nënligjore përkatëse për subvencionimin e interesave të kredive me kushte lehtësuese në favor të familjeve në nevojë për strehim dhe në përputhje me buxhetin e miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim, EKB do të vazhdojë gjatë vitit 2020 të kryejë procesin për:

- trajtimin me kredi me kushte lehtësuese me 0% interes në vit për të gjithë familjet e pastreha që banojnë në pronat e subjekteve të shpronësuara.
- subvencionimin e interesave të kredive për familjet e pastreha që janë trajtuar me kredi të lehtësuar me 3% interes në vit nga bashkitë respektive.
- subvencionimin e interesave të kredive për punonjësit e administratës së lartë shtetërore që kanë përfituar kredi të lehtësuara me 4 % interes në vit.

3. Procedurat për lirimin e banesave në zbatim të Aktit Normativ Nr.3 datë 01.08.2012 “ Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara”.

EKB, nëpërmjet strukturave në qendër dhe rrethe do të vijojë të kryejë edhe gjatë vitit 2020 procedurat në lidhje me kërkesat për lirim banese që do të depozitohen nga pronarët e banesave ku jetojnë familje me statusin e qiramarrësit në ish pronë private, por duke patur në vëmendje edhe kushtet sociale dhe ekonomike të këtyre familjeve me qëllim orientimin e tyre për të përfituar strehim me një nga format që mundëson dhe ofron shteti për këtë kategori.

5. Zbatimi dhe rishikimi i legjislacionit ku mbështetet veprimtaria e institucionit.

Për realizimin e detyrave të ngarkuara dhe arritjen e objektivave të përcaktuara EKB do të mbështesë veprimtarinë në zbatimin e legjislacionit përkatës në fuqi dhe njëkohësisht do të punojë për të përmirësuar këtë legjislacion duke përqendruar punën në këto drejtime:

- a) Hartim të propozimeve të nevojshme për ndërmarrje iniciative ligjore por edhe dhënie mendimi mbi propozimet e ardhura për iniciativa ligjore;
- b) Hartim të akt-marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet e vetëqeverisjes vendore, si edhe me institucione të tjera në funksion të ndjekjes dhe zbatimit të politikave të strehimit për familjet në nevojë;
- d) Hartim apo përpunim të kontratave tip si dhe të udhëzimeve që do të nevojiten për të qartësuar, saktësuar dhe përmirësuar procedurat që kryhen në zbatim të detyrave funksionale dhe të ngarkuara për të arritur realizimin e objektivave të përcaktuara.

5. Ndjekja dhe monitorimi i procedurave gjyqësore.

Ndjekja dhe monitorimi i procedurave gjyqësore për vitin 2020 do të kryhet në bashkëpunim me strukturat në qendër si dhe të gjitha strukturat në rrethe, me qëllim mbulimin dhe përfaqësimin e këtyre proceseve në të gjitha shkallët e gjykimit me një nivel të lartë profesional dhe do të përqendrohet në drejtim të:

- ndjekjes në vazhdimësi të proceseve të evidentuara që nga viti paraardhës dhe që janë aktualisht në proces gjykimi të evidentuara dhe që janë ndjekur dhe vijnë të ndiqen edhe gjatë vitit paraardhës nga strukturat përkatëse të EKB-së;
- hapjes së proceseve të reja nga Degët Rajonale ndaj klientëve debitorë në zbatim të Manualit të Menaxhimit të Debitorëve, të cilat në total sipas planifikimit të këtyre degëve janë parashikuar të hapen 98 procese gjyqësore dhe që do t'i gjeni të specifikuara dhe të ndara sipas degëve rajonale në pasqyrat bashkëlidhur materialit;
- ndjekjes së proceseve të tjera të paparashikuara të cilat mund të hapen gjatë vitit 2020 ndaj EKB-së nga persona juridikë apo fizikë, si dhe të proceseve gjyqësore që mund të hapë vetë EKB në rastet kur strukturat përkatëse të EKB-së në varësi të problematikave që evidentojnë apo në zbatim të detyrave që u janë ngarkuar, mbështetur në Gjurmën e Auditit për Proceset Gjyqësore të miratuar nga Këshilli Drejtues, relatojnë kërkesën së bashku me materialet e provat përkatëse për hapjen e proceseve gjyqësore në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe brenda afateve të parashikuara nga ky legjislacion.

6. Trajtimi dhe shqyrtimi i korrespondencës zyrtare.

EKB kryesisht nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme shqyrton dhe trajton kërkesat që vijnë nga qytetarët apo institucione shtetërore, në përputhje me hapësirat ligjore dhe kompetencat që ka institucioni. Edhe gjatë vitit 2020 trajtimi i korrespondencës do të vijojë të ndiqet nga të gjitha strukturat e EKB-së, me qëllim sqarimin, orientimin apo dhënien zgjidhje të problematikave që ngrihen nëpërmjet kërkesave dhe ankesave që mund t'i drejtohen institucionit tonë, duke respektuar afatet ligjore.

7. Kryerja e procedurave përkatëse në funksion të veprimtarisë që kryen Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Banesave.

Gjatë vitit 2020, referuar Programit Vjetor të Veprimtarisë së Këshillit Drejtues që do të miratohet për këtë vit kalendarik, por edhe në varësi të problematikave të ndryshme të dalta gjatë kryerjes së veprimtarisë së përditshme të institucionit, do të përgatiten nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme materialet përkatëse të cilat do t'i paraqiten Këshillit Drejtues për shqyrtim dhe vendimarrje. *Bashkëlidhur do të gjeni tabelat përmbledhëse të proceseve gjyqësore të planifikuara për t'u hapur nga Degët Rajonale gjatë vitit 2020.*

V. Mbi Planifikimin e Veprimtarisë së Sektorit të Auditimit për Vitin 2020.

Mbështetur në Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm, janë hartuar përkatësisht plani strategjik 2020- 2022 i auditimit dhe plani vjetor për vitin 2020 të miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 40, datë 31.10.2019.

Për vitin 2020 janë planifikuar të kryen 11 misione auditimi, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së subjektit publik që auditohet si dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm. Njësia e Auditimit do të ndikojë për të arritur objektivat e Institucionit në një mënyrë të disiplinuar dhe sistematike për të përmirësuar menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit të brendshëm.

Subjektet të planifikuara për auditim nga njësia e auditimit të brendshëm të EKB-së, në vitin 2020, janë : 9 misione auditimi të kombinuara dhe 2 misione auditimi të përputhshmërisë, si më poshtë:

1. Dega Rajonale Elbasan 2. Dega Rajonale Kukës 3. Dega Rajonale Durrës 4. Dega Rajonale Lezhë 5. Dega Rajonale Berat 6. Dega Rajonale Gjirokastrë 7. Dega Rajonale Korçë 8. Dega Rajonale Tiranë 9. Dega Rajonale Shkodër 10. Dega Rajonale Vlore dhe 11. Drejtoria e Përgjithshme e EKB.

Në programet e auditimit, mbi bazën e të cilit do të auditohen subjektet do të trajtohen tematikat :

- Auditim mbi rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme.- Auditim i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemi i drejtimit. Vlerësimi i riskut.- Auditimi që lidhet drejtpërdrejt me funksionet e sistemit kontabël, në zbatimin e ligjshmërisë në veprimet e kryera me bankë dhe arkë etj.
- Auditimi në zbatimin e ligjshmerisë për pagat e punonjësve- Auditimi në administrimin e vlerave materiale (inventarizimeve)
- Auditim i performancës, mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga aktiviteti, mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve, mbi zbatimin e ligjshmerisë në përdorimin e fondeve dhe burimeve të financimit, për kthimin e kredisë me këste, arkëtimin e kamatë vonesave nga klientët e parregullt.

- Auditim i pajtushmërisë, mbi prokurimet dhe mbi zbatimin e legjislacionit për kriteret e blerjeve dhe shitjeve të apartamenteve, zbatimi i kontratave, plotësimi i dosjeve të shitjeve dhe inventarizimi i tyre.
- Auditim mbi kreditë e dhëna për qytetarët, problematikat në lidhje me debitorët sipas “Manualit të Menazhimit të Debitorëve” dhe masat e mara për uljen e tyre. - Tematika të tjera të dala gjatë auditimit.

Në vazhdimësi krahas zbatimit të programit të vitit 2020, do të punojmë për të përmirësuar më tej standartet e auditimit, për të ritur efincencën dhe efektivitetin e punës sonë.

Këto ishin disa nga çështjet që menduam të trajtonim në këtë projekt-program dhe disa nga objektivat e parashikuara për vitin 2020.

Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa Nr.80, Hyrja 1, Kati i 5, (ish Shtëpia Botuse Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri,
Tel: +355 42 227 796 email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al